

HydroEnergy Sh.p.k
Pasqyrat Financiare
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

Përmbajtja

Raport i Audituesit të Pavarur	3
Pasqyra e Pozicionit Financiar.....	5
Pasqyra e Performancës	6
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital	7
Pasqyra e Rrjedhjes së Mjeteve Monetare	8
1. Informacion I Përgjithshëm	9
2. Baza E Përgatitjes Së Pasqyrave Financiare.....	10
3. Politikat Kontabël.....	10
4. Aktivitet Afatgjata Materiale.....	14
5. Aktive Financiare	15
6. Para Në Arkë Dhe Bankë.....	15
7. Llogari Të Arkëtueshme	15
8. Llogari Të Tjera Të Arkëtueshme	15
9. Kapitali I Paguar	15
10. Rezervat.....	15
11. Provizione	16
12. Të Pagueshme Ndaj Furnitorëve.....	16
13. Detyrime Të Tjera Afatshkurtra	16
14. Hua Afatgjata	16
15. Të Ardhurat.....	16
16. Shpenzime Për Punonjësit	17
17. Shpenzime Për Energji Dhe Materiale	17
18. Shpenzime Për Shërbime	17
19. Shpenzime Të Tjera Operative.....	17
20. Shpenzime Financiare	18
21. Tatim Fitimi	18
22. Transaksionet Me Palët E Lidhura.....	18
23. Ngjarje Pas Periudhës Raportuese.....	19

Margarita Kalemasi –Auditues Ligjor
NUIS: L51330007D - Liçensë Nr. 156
Rruga Asim Vokshi, Nd. 14, H. 6, A. 27,
1016, Tiranë, Shqipëri
Tel: +35542420666

Raport i Audituesit të Pavarur

Për aksionarët dhe drejtimin e HydroEnergy Sh.p.k

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të HydroEnergy Sh.p.k ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2020, dhe pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2020, dhe rezultatin e saj financiar dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara ("SKK").

Baza për Opinimin


Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me *Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël* të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël ("Kodi i BSNEPK") së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodin NSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të dhe për ato kontrole të brendshme që Drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijmësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Drejtimi është përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.



Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare


Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.


Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:


- ↳ Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazaë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- ↳ Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- ↳ Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- ↳ Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, të cilat mund të hedhin dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- ↳ Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në mënyrë që arrijnë paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtimin e HydroEnergy Sh.p.k, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.


Margarita Kalemasi
Auditues Ligjor



03 Mars 2021
Tiranë, Shqipëri


4

HydroEnergy sh.p.k

Pasqyra e pozicionit financiar për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2020

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

Pasqyra e Pozicionit Financiar

AKTIVET	Shënimi	31/12/2020	31/12/2019
Aktivitet Afatgjata			
Aktivitet Afatgjata Materiale			
Toka dhe ndërtesa	4	67,704,348	67,704,348
Ndërtesa	4	1,776,360,820	1,869,853,494
Makineri dhe pajisje	4	2,075,097	2,666,879
Totali i Aktiveve Afatgjata Materiale		1,846,140,265	1,940,224,721
Aktivitet Financiare	5	92,180,000	92,180,000
Totali i Aktiveve Afatgjata		1,938,320,265	2,032,404,721
Aktivitet Afatshkurtra			
Para në arkë dhe bankë	6	4,099,404	686,500
Llogari të arkëtueshme, klientë	7	12,086,137	50,219,297
Llogari të tjera të arkëtueshme	8	210,310,595	226,314,776
Totali i Aktiveve Afatshkurtra		226,496,136	277,220,573
TOTALI I AKTIVEVE		2,164,816,401	2,309,625,294
DETYRIMET DHE KAPITALI			
Kapitali			
Kapitali i paguar	9	1,444,108,950	1,444,108,950
Rezerva	10	19,991,264	19,991,264
Humbje e akumuluar		(335,093,028)	(278,905,093)
Humbja e Vitit		(103,477,940)	(56,187,935)
TOTALI I KAPITALIT		1,025,529,246	1,129,007,186
Detyrimet Afatshkurtra			
Provizione	11	11,106,118	11,106,118
Të pagueshme ndaj furnitorëve	12	237,876,608	211,992,063
Detyrime të tjera afatshkurtra	13	604,944	202,799
Totali i Detyrimeve Afatshkurtra		249,587,670	223,300,980
Detyrimet Afatgjata			
Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	14	450,564,485	513,033,628
Detyrime ndaj palëve të lidhura	14	439,135,000	444,283,500
Totali i Detyrimeve Afatgjata		889,699,485	957,317,128
TOTALI I DETYRIMEVE		1,139,287,155	1,180,618,108
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		2,164,816,401	2,309,625,294


Pasqyrat financiare të Shoqërisë më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 janë aprovuar nga drejtimi më 11 shkurt 2021 dhe firmosur nga:


Hartuese e Pasqyrave Financiare

Mejtina Kamberi

 **HYDROENERGY** Sh.p.k
Rr. Italo Vespaes Dalje Kombinat
Vadarrë, Tiranë, ALBANIA

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet bashkë me shënimet shpjeguese në faqet 9-19 që janë pjesë e pasqyrave financiare.


Drejtor Ekzekutiv
Dott. Giovanni Annoni
Dott. Matteo Fumagalli Romario



HydroEnergy sh.p.k


Pasqyra e performancës për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2020

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

Pasqyra e Performancës

Të ardhurat	Shënimi	31/12/2020	31/12/2019
Të ardhurat	15	98,094,515	129,480,047
Shpenzime operative			
Shpenzime për punonjësit	16	(4,763,334)	(5,213,865)
Shpenzime për energji dhe materiale	17	(43,623)	(187,131)
Shpenzime për shërbime	18	(17,024,954)	(16,354,442)
Shpenzime për qiranë		(150,210)	(148,533)
Shpenzime amortizimi		(94,084,456)	(98,235,095)
Provizione për rreziqe		-	(11,106,118)
Shpenzime të tjera operative	19	(1,360,262)	(828,504)
Totali i shpenzimeve operative		(117,426,839)	(132,073,688)
Shpenzimet financiare neto			
Fitime nga kurset e këmbimit	20	(18,990,346)	15,571,228
Shpenzime për interesat	20	(65,155,270)	(64,914,609)
		(84,145,616)	(49,343,381)
Humbja para tatimit			
Shpenzimi për tatim fitimit	21	(103,477,940)	(51,937,022)
HUMBJA NETO E VITIT		(103,477,940)	(56,187,935)

Pasqyra e performancës duhet të lexohet bashkë me shënimet shpjeguese në faqet 9-19 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



HydroEnergy sh.p.k


Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2020

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital

	Kapitali aksionar	Rezerva	Humbje të mbartura	Fitimi/(humbja) e vitit	Total
Pozicioni financiar më 01.01.2019	1,444,108,950	19,991,264	(325,667,156)	46,762,063	1,185,195,121
Transferime në kapital	-	-	46,762,063	(46,762,063)	-
Fitimi i vitit	-	-	-	(56,187,935)	-
Pozicioni financiar më 31.12.2019	1,444,108,950	19,991,264	(278,905,093)	(56,187,935)	1,129,007,186
Transferime në kapital	-	-	(56,187,935)	56,187,935	-
Humbje e vitit	-	-	-	(103,477,940)	(103,477,940)
Pozicioni financiar më 31.12.2020	1,444,108,950	19,991,264	(335,093,028)	(103,477,940)	1,025,529,246

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet bashkë me shënimet shpjeguese në faqet 9-19 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



HydroEnergy sh.p.k

Pasqyra e Flukseve të Parasë për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2020

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

Pasqyra e Rrjedhjes së Mjeteve Monetare

	31/12/2020	31/12/2019
AKTIVITETET E SHFRYTËZIMIT		
Humbja neto e vitit	(103,477,940)	(56,187,935)
Rregullime për:		
Zhvlerësim dhe amortizim	94,084,456	98,235,095
Ndryshime në:		
- llogari të arkëtueshme	54,137,341	(107,149,291)
- llogari të pagueshme	26,286,690	44,664,233
Fluksi i parasë neto gjeneruar nga aktivitetet operative	71,030,546	(20,437,898)
FLUKSI I PARASË NGA AKTIVITETE INVESTUESE		
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	0	(19,285,832)
Fluksi i parasë neto përdorur në aktivitetet investuese	0	(19,285,832)
FLUKSI I PARASË NGA AKTIVITETE FINANCUESE		
Rritja e kapitalit aksionar	-	-
Pagesa e huave	(67,617,643)	13,083,595
Fluksi i parasë neto përdorur në aktivitetet financuese	(67,617,643)	13,083,595
Rritje neto në para dhe ekuivalentët	3,412,904	(26,640,135)
Para dhe ekuivalentët në fillim të vitit	686,500	27,326,636
Para dhe ekuivalentët në fund të vitit	4,099,404	686,500

Pasqyra e rrjedhjes së mjeteve monetare duhet të lexohet bashkë me shënimet shpjeguese në faqet 9-19 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



HydroEnergy sh.p.k

Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2020

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

HydroEnergy Sh.p.k ("Shoqëria") është një shoqëri e themeluar dhe e regjistruar në Shqipëri. Adresa e Shoqërisë është Rruga e Kavajës, Vaqarr, Tiranë, Shqipëri. HydroEnergy Sh.p.k është regjistruar në datën 27 Mars 2009 në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), me NUIS K91527017E dhe aktualisht raporton pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

Shoqëria fillimisht është regjistruar si shoqëri konçesionare nga Euro-AL Sh.p.k dhe Energysolution Sh.p.k dhe u përfshi në një marrëveshje konçesionare BOT me objekt ndërtimin dhe shfrytëzimin e hidrocentraleve Murdhari 1 dhe Murdhari 2 në komunat Krrabë dhe Ibë.

Pas transferimit të aksioneve nga Energysolution Sh.p.k tek SOL S.p.A në qershor të vitit 2009, aktualisht Shoqëria zotërohet nga SOL dhe Euro-AL me 96.04% dhe 3.96% të kapitalit respektivisht.


Drejtuësit e Shoqërisë janë Z. Giovanni Annoni dhe Z. Matteo Fumagalli Romario.

Marrëveshja Konçesionare – Terma të rëndësishëm

Sipas nenit 78 dhe 83 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe Ligjit Nr. 9663 "Për Konçesionet" i datës 18.12.2006, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 310 "Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me konçesion të hidrocentralit "Murdhari 1", dhe miratimin e bonusit, në procedurën për zgjedhëse konçesuese, që i jepet shoqërisë" i datës 26.03.2008, u nënshkrua marrëveshja konçesionare ndërmjet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës – METE (aktualisht Ministria e Energjisë dhe Industrisë – MEI) dhe Bashkimi i përkohshëm i Shoqërive "Euro-AL" Sh.p.k dhe "Energysolution" Sh.p.k si Shoqëria Konçesionare për financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin dhe mirëmbajtjen e hidrocentraleve "Murdhari 1" dhe "Murdhari 2" dhe transferimin e tyre në përfundim të kontratës nga Konçesionari tek Autoriteti Kontraktues.

Sipas Marrëveshjes Konçesionare, Shoqëria ndërtoi dy njësi prodhuese hidroenergjitike (Murdhari 1 dhe Murdhari 2) me një fuqi të instaluar 2680 kW dhe 1000kW dhe me një prodhim energjie elektrike 10566570 kWh dhe 4195400 kWh respektivisht.

Marrëveshja është e organizuar si një model projekti i tipit BOT (Ndërtim-Operim-Transferim) dhe do të zgjasë për një periudhë fillestare prej 35 vjetësh nga data efektive. Pas kësaj periudhe, pronësia e hidrocentraleve do t'i transferohet MEI (më parë Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës-METE) pa asnjë tarifë, bashkë me pajisjet e operimit, të drejtat e garantuara dhe kontratat.



HydroEnergy sh.p.k

Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2020

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

Aktiviteti tregtar i Shoqërisë mbështetet nga Licencat e mëposhtme të dhëna nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE):

- Licenca për Prodhimin e Energjisë Elektrike Nr. 96, dhënë sipas vendimit të ERE Nr. 25 të datës 29.03.2010 me afat 30 vjet;
- Licenca për Tregtimin e Energjisë Elektrike Nr. 107, dhënë sipas vendimit të ERE Nr. 59 të datës 08.09.2010 me afat 30 vjet.

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Këto pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje Standardet Kombëtare të Kontabilitetit ("SKK").

2.2 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Pasqyrat financiare janë paraqitur në Lek, e cila është njëkohësisht dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.4 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që Drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto supozime.


Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen.

3. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të përmendura më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetarë në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në Lekë me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Aktivitet dhe detyrimet jo-monetarë në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit, ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit njihen përgjithësisht në fitime ose humbje.



HydroEnergy sh.p.k

Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2020

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është detajuar si më poshtë:

Monedha	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
1 EUR	123.70	121.77
1 USD	100.84	108.64

3.2 Instrumenta financiare

Instrumentat financiarë jo-derivative përbëhen nga të drejta të arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalente të tyre, llogari të financimeve të brendshme, llogari të pagueshme dhe detyrime ndaj palëve të lidhura.

Të gjitha aktivet dhe detyrimet financiare njohen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to. Pas njohjes fillestare, instrumentat financiarë jo-derivative njihen siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur mbarojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivitetin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivitetin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë mbarojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat bankare. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre mbahen me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

Të drejta të arkëtueshme

Të drejtat e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me koston të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjoni për zhvlerësimin e të drejtaeve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që të drejtat e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provigjonit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të skontuara me normën e interesit efektiv.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Vlera e drejtë

Vlera e drejtë e vlerësuar për mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre, të drejtat e arkëtueshme, llogaritë e pagueshme i përafrohen vlerës së tyre kontabël.

HydroEnergy sh.p.k

Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2020

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

3.3 Aktivët afatgjatë materiale

Njohja dhe matja

Aktivët afatgjatë materiale maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi i akumuluar. Kosto përfshin shpenzimet që lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me përgatitjen e aktiveve në gjendje pune për qëllimin e përdorimit të tyre; shpenzimet e çmontimit dhe heqjes së elementëve dhe rikthimit të tokës në gjendjen origjinale. Programet (software) e blerë të cilët janë pjesë tërësore në funksionalitetin e pajisjeve përkatëse, kapitalizohen si pjesë e kësaj pajisjeje. Kur pjesë të një aktiviteti material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato llogariten si të ndara (pjesë të rëndësishme). Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit të ndonjë aktiviteti përcaktohen duke krahasuar të ardhurat e marra nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën kontabël (neto) të aktivitetit dhe pasqyrohen neto në zërin të ardhura të tjera të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjatë të trupëzuara i shtohet vlerës së mbetur të elementit nëse është e mundur që përfitimet ekonomike në të ardhmen që lidhen me këtë element do të rrjedhin në Shoqëri, dhe kostoja e tij mund të matet me saktësi. Kostot e mirëmbajtjeve ditore të aktiveve afatgjatë të trupëzuara njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.

Amortizimi



Amortizimi llogaritet për të shpërndarë koston e aktiveve minus vlerën e tyre të mbetur gjatë jetës së dobishme dhe përgjithësisht njihet në të ardhura dhe shpenzime. Përmirësimet e ambienteve me qira amortizohen përgjatë afatit të qirasë. Aktivët në proces nuk amortizohen.

Normat e amortizimit janë zbatuar për periudhën aktuale dhe atë krahasuese.

• Toka	Nuk amortizohet
• Ndërtesa, rrugë etj.	5 %
• Pajisjet dhe makineritë	20%
• Automjete	20%
• Pajisje Zyre & Informatike	20 – 25%

3.4 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, Shoqëria ka një detyrim ligjor ose konstruktiv, i cili mund të vlerësohet me besueshmëri dhe do të kërkojë flukse dalëse monetare të ardhshme për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset monetare të ardhshme të pritshme me një normë skontimi para tatimit, e cila reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parës dhe rreziqet që lidhen me detyrimin në fjalë.



HydroEnergy sh.p.k

Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2020

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

3.5 Njohja e të ardhurave

Shoqëria është e përfshirë në tregëtimin e energjisë elektrike. Të ardhurat njihen kur rreziqet dhe përfitimet nga pronësia i janë transferuar klientit, rimarrja e shumës është e mundëshme, kostot e lidhura dhe kthimet e mundshme mund të vlerësohen me besueshmëri dhe shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose për tu arkëtuar, neto nga kthimet. Për shitjen e energjisë, transferimi i rreziqeve dhe përfitimeve ndodh kur sasia aktuale e energjisë hidhet në rrjet dhe matet në pikën e shpërndarjes.

3.6 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare



Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në fitime ose humbje. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet për interesat nga huatë dhe humbjet nga kursi i këmbimit.

Të ardhurat nga interesi dhe shpenzimet e interesit njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3.7 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi i periudhës aktuale njihet në fitim ose humbje, përveçse kur lidhet me elementë që njihen drejtpërdrejt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi i periudhës aktuale është tatimi i pritsëm për t'u paguar nga të ardhurat e tatueshme, duke përdorur normat tatimore në fuqi ose thelbësisht në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullimi të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Shuma e tatimit aktual të pagueshëm ose të arkëtueshëm përfaqëson vlerësimin më të mirë të bërë të tatimit që pritet të paguhet ose arkëtohet dhe që reflekton pasiguritë që lidhen me tatim fitimin, nëse ka. Ky tatim llogaritet duke përdorur normën tatimore në fuqi ose të hyrë në fuqi në datën e raportimit. Tatim fitimi aktual përfshin gjithashtu çdo tatim që rezulton nga dividendët. Tatim fitimi aktual i pagueshëm ose i arkëtueshëm kompensohen vetëm në qoftë se kritere të caktuara përmbushen. Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferenca të përkohshme ndërmjet vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimi. Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për humbjen tatimore të papërdorur, kreditimet tatimore të papërdorura dhe diferencat e përkohshme të zbritshme deri në masën që është e mundur që të kenë fitime të tatueshme në të ardhmen, kundrejt të cilave ato mund të përdoren. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në masën që nuk është më e mundur që përfitimi tatimor të realizohet. Këto zvogëlime rimerren, kur mundësia e fitimit të ardhshëm tatimor përmirësohet. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që pritet të zbatohen mbi diferencat e përkohshme kur të kthehen, në bazë të ligjeve në fuqi ose miratuar në datën e raportimit financiar. Matja e tatimit të shtyrë reflekton pasojat tatimore që do duhet të ndiqen nga mënyra se si Shoqëria pret, në datën e raportimit, të rikuperojë ose shlyejë vlerën e mbartur të aktiveve ose detyrimeve të veta. Aktivit tatimor i shtyrë kompensohet me detyrimin tatimor të shtyre vetëm në qoftë se kritere të caktuara përmbushen.




HydroEnergy sh.p.k

Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2020

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

4. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

Aktivitet materiale	Toka	Makineri	Të tjera instalime dhe pajisje	Totali
<i>Kosto</i>				
Më 1 janar 2019	67,704,348	2,460,659,477	4,868,206	2,533,232,031
Shtesa	-	18,123,256	1,162,575	19,285,831
Pakësime	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2019	67,704,348	2,478,782,733	6,030,781	2,552,517,862
Shtesa	-	-	-	-
Pakësime	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2020	67,704,348	2,478,782,733	6,030,781	2,552,517,862
<i>Zhvlerësim i akumuluar</i>				
Më 1 janar 2019	-	(511,163,977)	(2,894,069)	(514,058,046)
Shpenzime për vitin	-	(97,765,262)	(469,833)	(98,235,095)
Pakësime	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2019	-	(608,929,239)	(3,363,902)	(612,293,141)
Shpenzime për vitin	-	(93,492,674)	(591,782)	(94,084,456)
Pakësime	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2020	-	(702,421,913)	(3,955,684)	(706,377,597)
<i>Vlera e mbartur</i>				
Më 31 dhjetor 2019	67,704,348	1,869,853,494	2,666,879	1,940,224,721
Më 31 dhjetor 2020	67,704,348	1,776,360,820	2,075,097	1,846,140,265



HydroEnergy Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2020

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

5. AKTIVE FINANCIARE

Aktivët financiarë në vlerën 92,180,000 Lekë përfaqësojnë garancitë bankare të vendosura nga shoqëria për detyrime tatimore të cilat janë apeluar nga shoqëria.

6. PARA NË ARKË DHE BANKË

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Para në arkë	127,205	168,026
Para në bankë në LEK	3,759,796	313,310
Para në bankë në monedhë të huaj	212,403	205,164
Totali i parasë në arkë dhe bankë	4,099,404	686,500

7. LLOGARI TË ARKËTUESHME

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Të arkëtueshme nga klientë	12,086,137	24,904,581
Të tjera	-	25,314,716
Llogari të arkëtueshme neto	12,086,137	50,219,297

Llogaritë e arkëtueshme përfshijnë të arkëtueshme nga FTL-Furnizuesi i Tregut të Lirë (ish OSHEE- Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike) për shitjen e energjisë elektrike. Të tjera përfaqëson Energji Elektrike të prodhuar gjatë muajit dhjetor 2019 e cila faturohet në muajin janar 2020.

8. LLOGARI TË TJERA TË ARKËTUESHME

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
TVSH e arkëtueshme	208,926,519	224,930,700
Tatim fitimi i arkëtueshëm	1,379,968	1,379,968
Parapagime në doganë	4,108	4,108
Totali	210,310,595	226,314,776

9. KAPITALI I PAGUAR

Më 31 Dhjetor 2020 aksionarë të shoqërisë janë SOL S.p.A dhe EURO – AL Sh.p.k me 96.04% dhe 3.96% të kapitalit respektivisht.vlera e kapitalit është 1.444.108.950,00 LEK

10. REZERVAT

Rezervat e krijuara nga shoqëria më 31 dhjetor 2019 kanë një vlerë prej 19.991.264 LEK.

HydroEnergy Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2020

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

11. PROVIZIONE

Provizione në vlerën 11,106,118 Lek për detyrime fiskale potenciale.

12. TË PAGUESHME NDAJ FURNITORËVE

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Të pagueshme ndaj palëve të treta	6,041,027	16,026,808
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	231,835,581	195,965,255
Totali	237,876,608	211,992,063

13. DETYRIME TË TJERA AFATSHKURTRA

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Paga e shpërblime	391,600	-
Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi	109,510	86,926
Kontributet shoqërore e shëndetësore	103,834	115,873
Totali	604,944	202,799

14. HUA AFATGJATA

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Hua ndaj palëve të tjera	450,564,485	513,033,628
Hua ndaj palëve të lidhura	439,135,000	444,283,500
Totali	889,699,485	957,317,128

15. TË ARDHURAT

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Te ardhura nga shitja e energjise	98,094,515	129,480,047
Total	98,094,515	129,480,047

	31/12/2020	31/12/2019
Prodhim gjatë vitit	100,613,071	132,122,497
Tarifa koncesionare	(2,518,556)	(2,642,450)
Të ardhura nga shitjet NETO	98,094,515	129,480,047

Sipas kontratës koncesionare, Shoqëria paguan një tarifë koncesionare (concession fee) në bazë të prodhimit të energjisë e cila faturohet me notë krediti 2% të vlerës së energjisë së prodhuar për vitin përkatës. Duke qenë se sistemi i deklarimit të shitjeve në e-tax (www.tatime.gov.al) në deklarimin e FDP-ve e ngarkon pozitivisht këtë shumë, më poshtë jepen detajimet e shitjeve neto të energjisë elektrike.

HydroEnergy Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2020

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

16. SHPENZIME PËR PUNONJËSIT

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Pagat e punonjësve	4,240,865	4,597,999
Kontributet e sigurimeve	522,469	615,866
Totali	4,763,334	5,213,865


17. SHPENZIME PËR ENERGJI DHE MATERIALE

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Energji elektrike	42,643	42,850
Kancelari	980	144,281
Totali	43,623	187,131

18. SHPENZIME PËR SHËRBIME

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Shpenzime mirëmbajtje dhe riparime	7,259,874	2,502,504
Shpenzime për konsulenca nga të tretë	3,990,500	7,890,739
Shpenzime ruajtje roje private	2,955,000	2,909,183
Shpenzime për siguracione	1,934,217	1,978,496
Shpenzime karburanti	377,496	475,831
Shërbime bankare	208,645	181,960
Shpenzime për punonjësit	120,240	120,240
Shpenzime telekomunikacioni	113,983	97,860
Udhëtime e dieta	65,000	176,830
Shpenzime transporti	-	18,300
Shërbime doganore	-	2,500
Totali	17,024,955	16,354,442

Shpenzime për punonjësit në vlerën 120.240 Lek përfaqësojnë shumën e kontributeve të sigurimeve të paguara për drejtorët siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi.



HydroEnergy Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2020

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

19. SHPENZIME TË TJERA OPERATIVE

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Tatime të tjera	1,012,836	455,204
Shpenzime të tjera	122,074	119,400
Taksa dhe tarifa vendore	117,100	151,000
Tatim në burim	108,252	102,900
Totali	1,360,262	828,504


20. SHPENZIME FINANCIARE

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Fitime nga kurset e këmbimit	63,804	15,620,850
Humbje nga kurset e këmbimit	(19,054,150)	(49,623)
Totali i humbjeve nga kurset e këmbimit	(18,990,346)	15,571,228
Të ardhura nga interesat	-	-
Shpenzime për interesat	(65,155,270)	(64,914,609)
Totali i shpenzimeve për interesa	(65,155,270)	(64,914,609)
Shpenzime financiare neto	(84,145,616)	(49,343,381)

21. TATIM FITIMI

Shpenzimi për vitet që mbyllet më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 rakordon me pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve si më poshtë:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
(Humbja) para tatimit	(103,477,940)	(56,187,935)
Shpenzime të pazbritshme për qëllime fiskale		
- Të tjera		(4,250,913)
- Shpenzime të pazbitshme për qëllime fiskale	(230,325)	(11,328,418)
(Humbja) tatimore për vitin	(103,247,615)	(40,608,605)
Tatim fitimi i vitit (shpenzim) 15%	-	-



HydroEnergy Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2020

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

22. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA

Palë të lidhura me Shoqërinë konsiderohen:

1. individë ose anëtarë të afërm të familjes së tyre të cilët: (a) zotërojnë kontroll mbi Shoqërinë bashkarisht ose individualisht, (b) kanë ndikim mbi veprimtarinë e Shoqërisë (c) janë anëtarë të manaxhimit të shoqërisë.

2. entitete për të cilat plotësohet një nga kushtet: (a) entiteti dhe Shoqëria janë anëtarë të të njëjtit grup; (b) njëra nga entitetet është një filial ose një investim i një pale të tretë; (c) të dyja entitetet janë investim nga e njëjta palë e tretë; (d) një entitet është investim i një pale të tretë dhe ky i fundit është filial i tij; (e) entiteti është një plan përfitim pas-punësimit për punonjësit e Shoqërisë; (f) entiteti kontrollohet nga një individ që përmbush kriterin 1.

18.1 Veprime në lidhje me aktivitetin

Shoqëria ka marrëdhënie si palë e lidhur me shoqërinë memë dhe shoqëri brenda grupit. Një përmbledhje e balancave me palët e lidhura paraqitet më poshtë:

<i>Të pagueshme tregtare</i>	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
SOL S.p.A	231,761,361	195,634,284
G.T.S Sh.p.k	74,220	330,971
Totali	231,835,581	195,965,255

<i>Të pagueshme financiare</i>	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
SOL S.p.A	439,135,000	432,283,500
G.T.S sh.p.k	-	12,000,000
Totali	439,135,000	444,283,500

23. NGJARJE PAS PERIUDHËS RAPORTUESE

Pas datës së pasqyrave financiare nuk ka pasur ngjarje për të cilat të nevojiten rregullime në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

